



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE

Nr. _____ Prot

Tiranë më, _____._____2024

**NJOFTIM PËR MARRJE ME QIRA TË AMBJENTEVE PËR NEVOJA TË
SISTEMIMIT TË PUNONJËSVE TË AGJENCISË KOMBËTARE TË
EKONOMISË SË MBETJEVE**

Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, me qëllim plotësimin e nevojës për mjedise pune shtesë njofton se kërkon të marrë me qira ambiente për ushtrimin e veprimtarisë administrative të saj krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 06.03.2024, duke u bazuar në kriteret e si më poshtë:

I. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Funksioni	Nr. Zyra	Sip. min	Sip. totale
Zyra	3		
Magazina	1		
Tualete	2		
Sipërfaqja totale	Nga 120 – 140 m2		

- Ambient për zyra me sipërfaqe totale nga 120 m2 - 140 m2, ku duhet të përfshijë të paktën 3 ambiente për zyra, 1 magazinë dhe 2 tualete (të kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë);
- Lartësia e katit /kateve të jetë jo më pak se 2.75-3m;
- Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisur me matës të dedikuar të ujit dhe energjisë elektrike;
- Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi, të instaluar dhe plotësisht funksional;
- Ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune;
- Ambientet duhet të jenë të përfunduara me dyer, dritare, të lyera dhe të gatshme/të lira për t'u shfrytëzuar nga qiramarrësi;
- Dera kryesore hyrëse në këto ambiente duhet të jetë me konstruksion metalik;
- Ambientet të kenë ndricim natyral si edhe të garantohet hapja e dritareve për ajrim natyral;
- Ambientet duhet të jenë bosh dhe të lira, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate;

- Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi;
- Pagesa e qirasë do bëhet çdo muaj në llogarinë në lekë të qiradhënësit, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim, kundrejt lëshimit të faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, pagesa e detyrimeve do të kryhet nga AKEM në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet dhe shuma e detyrimeve do të zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë;
- Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) muaj me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës me qiradhënësin;
- Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit, internetit dhe ambienteve të përbashkëta gjatë periudhës së vlefshmërisë së Kontratës së qirasë do të përmbushen nga AKEM kundrejt faturave përkatëse;
- Ambjentet të jenë brenda unazës së vogël dhe në afërsi të institucionit Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, me adresë Rruga “Avdi toptani”, Pallati “Torre Drin”, H.2, Ap.4, 1001 Tiranë.

II. KRITERET E PRANIMIT/ KUALIFIKIMIT

Subjekti ofertues duhet të dorëzojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dokumentet si më poshtë vijon:

1. Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikate pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe Gent-planin.
2. Vetdeklarim nga ofertuesi që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekor apo detyrim tjetër ligjor.
3. Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.
4. Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.
5. Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.
6. Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
 - a- NIPT/NUIS, certifikata e regjistrimit dhe Ekstrat Historik i regjistrimit të subjektit që vërteton se ka status aktiv.
 - b- Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera.
 - c- Vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-Sigurime.
 - d- Vërtetim nga institucionet përkatëse që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale si dhe nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin.
 - e- Në ofertën e tij subjekti i interesuar, duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit.
7. Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.
8. Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore dhe kërkesave specifike të ambienteve që kërkohen nga Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.

9. Kopje ID e titullarit të pronës/ambienteve.

10. Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH.

11. Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve të specifikojë sipërfaqen dhe çmimin mujor (në LEKË) të qerasë (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i ambientit dhe të përmbajë të dhënat, sipas tabelës më poshtë).

Nr.	Emri dhe NIPT-i subjektit	Përshkrimi	Sip. Totale në m2	Çmimi pa TVSH (në lekë)	Çmimi me TVSH (në lekë)
1.		Ambjent për zyra me qira			

12- Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin më të ulët (oferta ekonomikisht më e favorshme) e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambienteve me qira për zyra, për punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë dhe Mbetjeve.

Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Dokumentacioni i kërkuar duhet të jetë i futur në një zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj. Mbi zarf duhet të jetë shënuar ofertë për marrje me qira ambient zyrash për ushtrimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM).

Ofertuesi të dorëzojë dokumentacionin deri në datën 25.11.2024, ora 10.00, pranë protokollit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve, në adresën: Rruga “Abdi Toptani”, Pallati “Torre Drin” H.2, Ap.4, 1001, Tiranë.